

## DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS

### Njoftim mbi të Drejtat Arsimore të Familjes sipas FERPA për shkollat Fillore dhe të Mesme 2013-2014

Dekreti për Mbrojtjen e të Drejtave Arsimore të Familjes (FERPA) u ofron prindërve dhe nxënësve mbi 18 vjeç (“nxënësit e ligjshëm”) të drejta specifike lidhur me rekordet mësimore të nxënësve. Këto të drejta janë:

(1) E drejta për inspektim dhe rishikim të rekordeve mësimore të nxënësit brënda 45 ditëve, nga dita që shkolla ka marrë kërkesën për rishikim të këtyre të dhënave.

Prindërit ose nxënësit që kualifikohen, duhet t’i paraqesin drejtorit të shkollës (ose nëpunësit përkatës të shkollës) një kërkesë me shkrim ku identifikojnë rekordet, të cilat dëshirojnë të shqyrtojnë. Nëpunësit e shkollës duhet të marrin masat për të krijuar këtë mundësi dhe njoftojnë prindin ose nxënësin e ligjshëm mbi kohën dhe vendin, ku atyre u jepet mundësia e shqyrtimit të këtyre të dhënave.

(2) E drejta për të kërkuar korigjimin e rekordeve mësimore të nxënësit, nëse prindi ose nxënësi i ligjshëm beson se nuk janë të sakta

Prindi ose nxënësi mund t’i kërkojë shkollës të korigjojë një nga ato rekorde, që ata besojnë se nuk janë të sakta. Ata duhet t’i shkruajnë drejtorit të shkollës (ose një nëpunësi përkatës), të specifikojnë qartë atë pjesë të këtyre të dhënave, që ata duan të ndryshojnë dhe ku shpjegojnë se, pse është kjo pasaktësi. Nëse, shkolla vendos të korigjojë këtë rekord siç është kërkuar nga prindi ose nxënësi, shkolla do të njoftojë prindin ose nxënësin mbi vendimin dhe këshillojë ata mbi të drejtën e tyre për një seancë dëgjimore, lidhur me kërkesën e tyre për këtë korigjim. Informacion shtesë lidhur me procedurat e seancës dëgjimore do t’i jepet prindit dhe nxënësit, kur ata të njoftohen mbi të drejtën e kësaj seance.

(3) E drejta e dhënies së miratimit mbi shpërndarjen e informacionit identifikues personal që përmbajnë rekordet arsimore të nxënësit, përveç rasteve, kur FERPA autorizon dhënien e informacionit pa miratim.

Një përjashtim, që lejon dhënien e informacionit pa miratim të prindit, është dhënia e tij, nëpunësve të shkollës mbi bazën e interesave legjitime arsimore. Nëpunës shkollë është një person i punësuar nga shkolla si drejtues, supervisor, mësues ose anëtar tjetër mbështetës i shkollës (përfshirë personeli mjekësor dhe i shëndetit, dhe personeli i policisë shkollë); një individ që punon në Bordin e shkollës; një individ ose kompani me të cilët shkolla ka kontratë për kryerjen e një detyre specifike (si gjykatës, revizorë financiarë, konsulentë mjekësorë, ose terapistë); një prind ose nxënës që shërben në komitetin e shkollës, si komiteti i disiplinës apo ankesave, ose ndihmon një shkollë tjetër në kryerjen e detyrave të tij/saj.

Një nëpunës shkollë ka interesa legjitime arsimore nëse, atij do t’i duhet të rishikojë rekordet arsimore, në mënyrë që të përmbushë përgjegjësinë profesionale të tij/saj.

Nëse bëhet një kërkesë, shkolla i lëshon rekordet pa miratim, nëpunësit të një shkollë tjetër, në të cilën nxënësi synon ose kërkon të regjistrohet. [SHENIM: FERPA kërkon që drejtoria arsimore të bëjë përpjekje të përgjegjshme për të njoftuar prindin ose nxënësin mbi kërkesën e rekordeve, vetëm nëse nuk shpallet në njoftimin vjetor, që shkolla synon të jap rekorde të nxënësit nëse bëhet një kërkesë e tillë.]

(4) E drejta për të paraqitur një ankesë në Ministrinë e Arsimit të U.S. që kanë të bëjnë me pretendimet e *Drejtorisë Arsimore* mbi mosrealizimet për të qënë në përputhje me kërkesat e FERPA-s. Emri dhe adresa e Zyrës që administron FERPA janë:

Family Policy Compliance Office  
U.S. Department of Education  
400 Maryland Avenue, SW  
Washington, DC 20202-590

Për informacione dhe dokumenta të tjerë të përkthyer në Gjuhën Shqipe, ju lutemi vizitoni uebsajtin:

[www.philasd.org/language/albanian](http://www.philasd.org/language/albanian)